

# Pesë virtyte themelore



*Hazret Mirza Tahir Ahmed<sup>ra</sup>*

# **Pesë virtyte themelore**

***Hazret Mirza Tahir Ahmed***

*Allahu e mëshiroftë*

**Kalif i Katërt i Mesihut të Premtuar**

**Tiranë, 2016**

## Pesë virtyte themelore

## پانچ بنيادی اخلاق

Autor: *Hazret Mirza Tahir Ahmed* Allahu e mëshirofë  
Kalif i Katërt i Mesihut të Premtuar

(Albanian translation of “*Five Basic Morals*”)

*Fjalim i së premtës i mbajtur më 24 nëntor të vitit 1989.*

Botimi i parë në shqip: 2016

© Islam International Publications

*E përktheu nga origjinali: Samad Ghori*  
*Redaktor gjuhësor: Besmir Yveysi*

### **Botues:**

Islam International Publications Ltd.  
Islamabad, Sheephatch Lane,  
Tilford, Surrey GU10 2AQ, UK

*Design: Petani Design, Tiranë*  
*U shtyp në shtypshkronjën: Gent.grafik, Tiranë*

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni:

Anglisht: [www.alislam.org](http://www.alislam.org)

Shqip: [www.alislam.al](http://www.alislam.al)

ISBN: 978-1-84880-259-9

## Parathënie

“Pesë virtyte themelore” është një hutbe e së xhumasë e mbajtur nga *Hazret Mirza Tahir Ahmed*, Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar, Allahu e mëshiroftë, më 24 nëntor të vitit 1989, pikërisht në vitin kur Xhemati Musliman Ahmedia do të hynte në shekullin e dytë të tij. Në një kohë kaq të rëndësishme, udhëheqësi shpirtëror i Xhematit u tërheq vëmendjen anëtarëve që popujt që synojnë suksese madhështore, u duhet së pari të hedhin themele të forta. Dhe, themelet e forta në këtë kontekst janë virtyte bazë, të cilat e bëjnë njeriun të pamposhtshëm dhe, gjithashtu, e aftësojnë për të sjellë ndryshime të pastra në shoqëri.

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

*“Në xhematin tonë nuk kemi nevojë për të fortët dhe mundësit fizikë, por na nevojiten ata që mund të përpiqen për të ndryshuar sjelljet e tyre. E vërteta është që i fortë dhe mundës nuk është ai që lëviz malin nga vendi i tij. Jo, jo. Trim i vërtetë është ai që arrin të ndryshojë sjelljet e tij. Ndaj, shfrytëzoheni gjithë kurajën dhe forcën tuaj për të sjellë virtyte në jetën tuaj, sepse kjo pikërisht është trimëria dhe forca e vërtetë”.* (“Malfuzat”, vëll. 1, botimi i vitit 2016, f. 121)

*“Virtytet çelin mirësi të tjera. Ata që nuk përmirësojnë veset e tyre, dalëngadalë mbeten pa mirësi. ... Prandaj, mbajeni mend! Është shumë e nevojshme të përmirësoni sjelljet tuaja, sepse pikërisht sjelljet janë nëna e mirësive.*

*Shkalla e parë e mirësisë, aty ku njeriu fiton forcë, është ajo e virtyteve. ... Bukuria e vërtetë e njeriut është bukuria e virtyteve të tij. Të paktë janë ata që e njohin këtë. Virtytet janë çelësi i mirësisë.*

*... Kujtdo që i është dhënë sadopak forcë prej virtytesh, ai ka gëzuar mundësinë për të bërë shumë vepra të mira. Pikërisht heqja dorë nga virtytet përbën mëkat dhe ligësi". ("Malfuzat", vëll. 1, botimi i vitit 2016, f. 481-482)*

Ky fjalim është përkthyer në shqip nga z. Samad Ghorri, kurse redaktimin e bëri z. Besmir Yvejsi. Po ashtu, znj. Kudsia Ghorri e ndihmoi përkthyesin në krahasimin e përkthimit me tekstin origjinal. Zoti i shpërbleftë!

*Ves-selam*

Munir-ud-Din Shams

*Add. Vakilit-Tasnif*

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

25 shtator 2016

## Pesë virtyte themelore

(Hutbeja e së xhumasë e Hazret Kalifit të Katërt të Mesihut të Premtuar, e mbajtur më 24 nëntor të vitit 1989, në xhaminë Bejtul Fazl, të Londrës).

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ<sup>1</sup>  
وَ أَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ  
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ  
بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①  
الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ① الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ①  
مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ① إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ①  
إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ① صِرَاطَ الَّذِينَ  
أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ ① غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ②

---

1. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Ai është Një dhe i pashoq. Po ashtu, dëshmoj se Muhammedi është rob e i dërguar i Tij. Pas kësaj, kërkoj mbrojtjen e Allahut nga djalli i mallkuar.

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve;

të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit;

Sunduesit të ditës së gjykimit.

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.

Na udhëzo në rrugën e drejtë.

Në rrugën e atyre që i bekove, që nuk tërhoqën zemërim dhe që nuk devijuan.

(Botuesi)

Ata që bëjnë plane madhore, duhet të bëjnë shprehi t'u kushtojnë vëmendje të veçantë gjërave themelore. Nganjëherë disa njerëz që pretendojnë të bëjnë deklarata dhe plane madhore, nuk i marrin fare parasysh gjërat fillestare, ndërkohë pikërisht ato, në të vërtetë, kanë rëndësi themelore. Derisa nuk vendosen themelet, nuk mund të ndërtohet asnjë ndërtesë e lartë. Ky është një ligj, të cilin nuk mund ta anashkalojë asnjë inxhinier a mjeshtër në botë.

### **Dy gjëra të rëndësishme në ndërtimin e popujve**

Në ndërtimin e popujve, e kam fjalën për popujt fetarë, pra, në ndërtimin e popujve fetarë, dy gjëra kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe pikërisht rreth tyre vërtitet e gjithë filozofia e jetës dhe ato janë: lidhja me robin dhe lidhja me Zotin. Islami ka dhënë mësimë shumë të gjera rreth këtyre dy lidhjeve dhe ka paraqitur një planprogram madhor. Por këtë planprogram mund ta vëmë në jetë vetëm atëherë, kur do t'u japim vëmendje të veçantë gjërave fillestare të tij dhe, me durim, t'i hedhim themelet e më pas, duke u mbështetur te bekimi i Zotit të Madhërishëm, të shpresojmë se do të mund të ndërtojmë ngrehina madhore mbi to.

Kjo epokë e Xhematit Musliman Ahmedia ka rëndësi të jashtëzakonshme. Siç ju kam tërhequr vëmendjen shumë herë, ne tashmë po i largohemi shekullit të parë të Mesihut të Premtuar a.s.. Pra, po i largohemi në rrafshin kohor. Por është plotësisht e mundur, madje Kurani Famëlartë shprehimisht e ka paraqitur si profeci që, largësia kohore edhe mund të shkurtohet dhe mund të tejkalohet, po të mos lejohet zhdukja e virtyteve dhe veprave.

وَآخِرِينَ مِنْهُمْ لَمَّا يَلْحَقُوا بِهِمْ ط  
وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ①

“Dhe Ai do ta dërgojë atë edhe tek të tjerë nga ata, të cilët ende nuk u janë bashkuar. Ai është i Plotfuqishmi, i Urti”.

(Kurani Famëlartë 62:4)

Mesazhi dhe sihariqi në këtë ajet është po ai, me përbushjen e të cilit, na është ngjallur besimi edhe një herë. Kjo është diçka shumë e rëndësishme. Edhe pse jemi të mëvonshmit, por duke qenë të lidhur me këtë profeci të Kuranit Famëlartë, kemi parë me sy dhe *de fakto* e kemi provuar para botës që largësia kohore mund të zhduket përmes afrisë së virtyteve. Përmes veprave mund t'i tejkalojmë largësitë kohore, edhe të së kaluarës, edhe të së ardhmes.

Nga ky këndvështrim, është e rëndësishme për ne që në krye të çdo shekulli, të shohim se hapi ynë a lidhet me shekullin e kaluar apo jo. Në virtyte e në vepra, mos vallë po rritet largësia midis nesh e të parëve?! Kështu që, marshimi ynë do të jetë në dy mënyra: një në rrafshin kohor, që është i pashmangshëm dhe një tjetër është ai që në dukje mund të jetë përparimtar, siç përparojnë popuj të ndryshëm, por në thelb mund të jetë rënie, siç popujt bien moralisht. Ky lloj përparimi në fakt është shenjë rënieje. Në këtë aspekt, ne nuk duhet të ecim para, por duhet të kthehemi. Mrekullia më e madhe që ka treguar Mesihu i Premtuar a.s., arritja më e madhe e tij është pikërisht ajo e kthimit e jo e ecjes përpara. Ai erdhi pas 13 shekujsh, por në ç'mënyrë vallë u vendos, krejt papritmas, në atë kohë, e cila ishte koha e *Hazret* Profetit Muhammed s.a.v.s.?! Kështu që, në krye të çdo shekulli të ardhshëm, kemi nevojë të hedhim një hap drejt kthimit dhe me vendime të qarta e të prera, të hartojmë një program



të tillë, që edhe pse në kohë do të ecim përpara, por ai program të na të bëjë të mundur kthimin tonë në vlera virtytesh dhe veprash.

Në këtë aspekt, kur shoh në të katër anët në këtë kohë, përveç shtrirjes së xhematit, më duken edhe disa shqetësime. Xhemati, me bekimin e Allahut të Madhërishëm, po përparon me hapa të shpejtë. Përparimi i tij në çdo vend është më shumë se kurdoherë. Në vendet ku kemi xhemat në numër të madh, rritja e xhematit është e bekuar në njërën anë, por në anën tjetër është edhe shqetësuese. Në xhematet e mëdha, kur vijnë breza të rinj, qoftë përmes lindjeve, vetvetiu rritet shqetësimi për edukimin e tyre.

Prandaj, kur mora vendimin për të marrë nën kujdesin tim organizatën e *Khudamul-Ahmediasë* (të rinjve), të *Ensarullahut* (të moshuarve) dhe të *Laxhnasë* (grave) të të gjitha vendeve të botës, kisha si synim që drejtpërdrejt t'i merrja ato shërbime prej këtyre organizatave, të cilat, me bekimin e Zotit të Madhërishëm, të na plotësojnë nevojat e edukimit të anëtarëve të xhematit. Dhe, *Khudamul-Ahmedia*, *Ensarullah* dhe *Laxhna Imail-lah* le të mos ndërtojnë kështjella imagjinare, por të bëjnë detyra të vogla një herë, që neve të na plotësohet nevoja sa për të mbuluar kokën. Kjo ishte nevoja për të cilën kam marrë këtë hap.

Në vazhdë të këtyre përpjekjeve, sot do t'i paraqes xhematit dy plane fillestare. U drejtohem në veçanti tri organizatave që përmenda pak më parë. Në dashtë Zoti i Madhërishëm, ato do të marrin udhëzime të herëpashershme dhe, në grupe-grupe, do të ngarkohen me programe të lehta, por praktike. Por, çështjet që sipas meje kanë rëndësi themelore, jua kam shtjelluar edhe më përpara në mënyra të ndryshme dhe ndiej të nevojshme përsëritjen e disave prej tyre edhe sot.

## **Në ngritjen e popujve fetarë, gjëja më e rëndësishme është ngritja e virtyteve**

Popujt fetarë nuk mund të ngrihen, pa ngritjen e virtyteve të tyre. Është krejtësisht i pavërtetë mendimi që njeriu të jetë edhe i keq në sjellje, edhe të jetë njohës i Zotit. Prandaj, në ngritjen e popujve fetarë, gjëja më e rëndësishme është ngritja e virtyteve të tyre. Një popull sa më shpejt ta fillojë këtë ngritje, aq më mirë do të jetë për të dhe aq më i lehtë do të jetë rrugëtimi i tij. Në këtë aspekt, organizata e grave është ajo që duhet të bëjë detyrën më fillestare dhe më themelore. E njëjta detyrë, në një pjesë tjetër të moshës, do t'u besohet të rinjve (*khudamëve*) dhe të moshuarve (*ensarëve*). Pra, në thelb, është një punë, të cilën këto organizata do ta bëjnë me grupmosha të ndryshme.

### **1. Shprehia e të thënit të vërtetën**

Gjëja e parë është shprehia për të thënë të vërtetën. Shkaku kryesor i gjithë ligësisë së përhapur sot në botë, është gënjeshtria. Popujt që janë të përparuar, të cilët në dukje quhen popujt me virtyte të larta, gjithashtu e përdorin gënjeshtren sipas nevojës së tyre: nëse jo ndaj njerëzve të vet, e përdorin ndaj të tjerëve. Filozofitë e tyre janë të bazuara mbi gënjeshtren. Sistemi i jetesës së tyre është i bazuar mbi gënjeshtren. Sistemi i tyre financiar është i bazuar mbi gënjeshtren. Pra, nëse do t'i analizoni thellë punët e tyre, në dukje ato përmbajnë stemën e civilizimit dhe të kulturës madhore, por në të vërtetë, në epiqendër e kanë gënjeshtren. Pikërisht mbi gënjeshtren janë ndërtuar civilizimet e tyre. Por kjo është një temë tjetër. Unë interesohem në Xhematin Ahmedia. Shoh me vëmendje të veçantë fëmijët e Xhematit Ahmedia. Sipas meje, nëse nuk i edukojmë fëmijët

që në vegjëli me shprehinë për të thënë të vërtetën, është shumë e vështirë që ata të pajisen me këtë virtyt kur të rriten. Në fjalime të ndryshme, ju kam shpjeguar gjerësisht se edhe të thënë të vërtetën ka nivele dhe faza të ndryshme. Një që thotë pak të vërtetë, një tjetër që thotë shumë të vërtetë, një tjetër që thotë akoma më shumë të vërtetë dhe kështu kemi nivele pa fund të të thënit të vërtetën, të cilat arrijnë deri te profetësia, pra te të qenët profet. Pas nivelit të *sidikut*, pozita që Zoti i Madhërisëm ka caktuar, është pikërisht ajo e profetësisë. Pra, i vërtetë i tillë, saqë të mos ketë asnjë aspekt gënjeshtre në veten e tij. Këto janë planprograme madhore që na ka lënë Kurani Famëllartë për t'i zbatuar.

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ  
الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ  
وَالصَّادِقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ  
وَحَسَنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا ۗ

*“Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata që Allahu i ka bekuar (domethënë), ndër profetët, të vërtetët (sidikët), dëshmorët dhe të sinqertët (salihët). Sa shoqëri e mbarë qenka kjo!”*

(Kurani Famëllartë 4:70)

Sa synime të larta e madhore qenkan këto! Por, ato fillojnë me të vërtetën. Askush nuk mund të bëhet *salih* (i drejtë, i vërtetë), derisa nuk i përmbahet së vërtetës, andaj, është shumë e rëndësishme që t'i aftësojmë fëmijët tanë që nga fillimi edhe butësisht, edhe rreptësisht, që ata të qëndrojnë mbi të vërtetën dhe me asnjë kusht të mos durojmë as ndonjë shaka të tyre të gënjeshtërt. Po e bënë këtë detyrë nënat, hapat e tjerë për popullin do të bëhen shumë të lehtë. Fëmijët që janë brumosur me të vërtetën, më vonë kur do t'u besohen qoftë

organizatës së grave (të *Laxhnasë*), qoftë asaj të rinjve (*Khudamul-Ahmedia*), do të jenë të aftë të realizojnë çdo punë që do t'u kërkoni, sepse pa të vërtetën, nuk mund të gjeni dot atë fibër, ose atëthurje, që mund të ngrejë ngarkesa të rënda, ose me të cilën mund të bëni plane të mëdha.

Popujt gënjeshtarë janë të dobët. Ata nuk kanë as fuqi për të duruar vlera të larta, por kjo është një temë shumë e gjerë dhe më lejoni ta mbaj ndonjëherë tjetër. Në këtë moment, do të doja të më besoni se pa të vërtetën, nuk mund të hidhet themeli i asnjë vlere të lartë, i asnjë plani madhor. Prandaj, në Xhematin Ahmedia, është jashtëzakonisht e nevojshme që t'i brumosim fëmijët tanë me shprehinë e të thënit të vërtetën, që t'i aftësojmë ata të jenë të vendosur me qëndrueshmëri të plotë mbi të vërtetën. Të rriturit e xhematit duhet të jenë vigjilentë dhe të rinjtë, të moshuarit dhe gratë e xhematit vazhdimisht duhet të bëjnë programe për të ndërgjegjësuar vlerën e madhe që ka e vërteta dhe se sa e nevojshme është kjo për xhematin dhe për botën përmes xhematit.

## **2. Butësia dhe dëlirësia në fjalë**

Virtyti i dytë për edukimin (e xhematit) është përdorimi i një gjuhe të butë e të dëlirë dhe respektimi i njëri-tjetrit. Edhe kjo në dukje është diçka e vogël dhe fillestare, por me sa kam analizuar, të gjitha grindjet që lindin përbrenda xhematit ose që shfaqen në marrëdhëniet tona midis njëri-tjetrit, pas gënjeshtres, shkak kryesor i tyre është që disa njerëz nuk dinë të flasin butë. Kjo sepse ata janë të vrazhdë në fjalë, janë të prirë për të lënduar të tjerët me fjalët dhe gjestet e tyre dhe, nganjëherë, ata vetë nuk janë të vetëdijshëm për këtë ves të tyre. Ashtu siç gjembat të shpojnë, por vetë nuk janë të

vetëdijshëm për veprimin e tyre, në të njëjtën mënyrë, disa njerëz shpirtërisht vyshken dhe bëhen si gjemba. Fjalët e tyre të përditshme përhapin vetëm shpime e lëndime në katër anë, ndërkohë ata as nuk e ndiejnë se çfarë po bëjnë. Të tillët nëse janë burra, gratë e tyre të gjora gjithmonë mbeten shënjestër e mizorive të tyre dhe nëse janë gra, burrave të tyre u bëhet jeta skëterrë.

Edhe kjo pikë është aq e rëndësishme që duhet t'ua mësojmë fëmijëve që në vegjëli. Kur fëmijët flasin me njëri-tjetrin në shtëpi, me fjalët e tyre nëse nuk respektojnë njëri-tjetrin dhe nuk shprehin dashuri ndaj njëri-tjetrit, qoftë për gjëra të vogla, nëse fillojnë të grinden e të shajnë njëri-tjetrin, atëherë dijeni se jeni duke lënë pas një brezni të ligë; jeni duke krijuar një brezni, e cila në të ardhmen do ta mbush popullin me plagë e me dhimbje dhe do të jeni ju përgjegjës të kësaj situatë, sepse kur fëmijët tuaj para syve tuaj kanë shkelur njëri-tjetrin, kanë shtrënguar njëri-tjetrin dhe kanë treguar mosrespektim ndaj njëri-tjetrit, ju nuk morët mundimin për t'i edukuar ata. Fëmijët e tillë, madje, bëhen edhe më të këqij sesa prindërit e tyre. Ata prindër që nxitojnë të ngrenë dorën për t'i rrahur fëmijët e tyre në shenjë qortimi, edhe fëmijët e tyre fillojnë të ngrenë dorën kundër prindërve të tyre.

Prandaj, ka nevojë t'i japim rëndësi të jashtëzakonshme mirësjelljes sonë dhe respektimit të ndërsjellë në jetën e përditshme. Edhe ky edukim, nëse do t'u jepet fëmijëve që në vegjëli në shtëpitë e tyre, me bekimin e Allahut të Madhërishëm shumë lehtë mund të arrihet synimi. Por, nëse mungesa e këtij virtyti bëhet pjesë e jetës, atëherë fëmijët e tillë, siç e dini, edhe kur shkojnë në shkollë, bëjnë shfaqje prej keqsjelljes, shqetësojnë njëri-tjetrin dhe për mësuesit gjithnjë mbeten një dhimbje koke. Fëmijët e tillë nëse hynë në organizatën e fëmijëve të xhematit (*Atfalul-Ahmedia*) ose vajzat në organizatën

e grave (*Laxhna Imail-lah*), krijojnë vetëm probleme. Do të jetë i zorshëm edukimi i tyre. Dhe po të na mungojë kjo lëndë fillestare, nuk mund t'i realizojmë dot detyrat madhore të edukimit, me të cilat jemi ngarkuar. Nëse do të kemi të gatshme lëndën fillestare ose themelin, mund të bëjmë punë sado të mëdha mbi të, mund ta zbukurojmë atë si të duam. Por nëse vetë dheu nuk do të jetë i butë dhe ai nuk do të ketë aftësi të ndryshojë veten, artisti sado i madh goftë, nuk mund ta kthejë atë në sende të bukura.

Në këtë aspekt, është shumë e domosdoshme mirësjellja jonë ndaj njëri-tjetrit, përdorimi i një gjuhe të butë dhe respektimi i njëri-tjetrit. Edhe grindjet e mëdha lindin për shkak të mungesës së këtij virtyti. Ngaqë mua më vijnë raste të ndryshme grindjesh nga e gjithë bota, herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, herë edhe nëpërmjet të tjerëve, ndjeva të nevojshme t'ju tërheq vëmendjen se derisa nuk do t'i edukojmë fëmijët tanë me respektin e gjuhës, nuk mund të garantojmë kontributin e tyre në ndërtimin pozitiv të popullit tonë. Keqsjelljet e tyre mund të krijojnë trazira shumë të rrezikshme, për shkak të të cilave, mund të përhapen dhimbjet, mund të përçahen xhemate, mund të lindin hipokritë dhe mund të largohen njerëz nga xhemi. Këto janë gjëra të vogla, që njerëzit i mendojnë si të pavlera, por pikërisht mbi to ngrihen popujt në të ardhmen dhe pikërisht përmes tyre mund të realizohen gjërat e mëdha.

### **3. Durimi dhe vetëpërmbytja**

Vetia e tretë është durimi dhe vetëpërmbytja. Që në vegjëli duhet të edukojmë fëmijët se nëse dikush u thotë ndonjë fjalë të rëndë ose kanë pësuar ndonjë humbje, nuk ka nevojë të shqetësohen, përkundrazi, të kenë vetëpërmbytje të lartë. Por, edhe këtë mësim

të vetëpërmbytjes nuk mund t'ua jepni thjesht me fjalë, por me vepra. Disa fëmijë nganjëherë shkaktajnë ndonjë humbje; thyejnë ndonjë enë në shtëpi, rrëzojnë bojën e shkrimit, rrëzojnë gotën e ujit gjatë bukës etj., për gjëra të vogla si këto, kam vënë re që disa prindër skuqen nga zemërimi dhe u vërsulen fëmijëve, i shajnë, u heqin shuplaka dhe i ndëshkojnë në mënyra të ndryshme. Madje, në popujt ose në vendet ku shtresa e të pasurve mbajnë shërbëtorët, ka syresh që me ta sillen akoma më keq. Pra, një popull që sillet keq me shërbëtorët, ose me fëmijët në shtëpi, nuk mund të ketë kurajë të fortë.

Mesihu i Premtuar a.s. i edukoi fëmijët e tij, jo thjesht me fjalë, por duke treguar virtyte të larta. I biri i tij, *Hazret Kalifi i Dytë r.a.*, kur ende ishte fëmijë, thjesht duke lozur i kishte vënë flakë dorëshkrimit të një veprë të tij shumë të vyer, që ishte gati për botim. Të gjithë njerëzit e shtëpisë i zuri frika se çfarë do të ndodhte dhe se si do të ndëshkohej fëmija, por kur Mesihu i Premtuar a.s. e mori vesh, tha:

*“S’ka problem. Zoti do të më japë mundësi të tjera”.*

Tek fëmijët vetëpërmbytjen mund ta gdhendni me modelin tuaj. Prindërit që vetë nuk janë të kalitur me durim e vetëpërmbytje, as fëmijëve nuk mund t'ua japin atë. Edhe butësia në fjalë ka lidhje të ngushtë me durimin. Njerëzit me kurajë të shkurtër gjithnjë bëhen edhe fjalëvrazhdë, kurse ata që kanë kurajë të lartë, jo vetëm që frenojnë gjuhën, por edhe e shkëlqejnë atë.

Vetëm të jeni fjalëmbël nuk mjafton, derisa nuk e forconi edhe durimin njëkohësisht. Durimi i fortë do t'i duhet shumë xhematit në të ardhmen. Dobitë e tij të jashtëzakonshme do t'i shohim edhe përbrenda xhematit, por edhe jashtë tij. Megjithatë, vetëpërmbytje e thellë nuk do të thotë që të durojmë çdo humbje dhe të mos

merakosemi fare për humbjet. Ky është dallimi që dua t'ju shpjegoj me hollësi. Duke e kuptuar këtë, t'i krahasoni këto dy gjëra që sapo thashë.

Humbja është e dëmshme. Nëse fëmijët priren të shkaktojnë humbje, duhet t'u mësojmë, t'u japim mend e t'u ngulitim në kokë që çdo gjë që ka krijuar Zoti i Madhërishëm është për dobinë tonë, prandaj, duhet të kemi merak të mos humbim asnjë gjë të vogël. Nuk duhet të humbim ujin duke marrë abdes. Nuk duhet të humbim ujin duke pastruar fytyrën dhe duart. Nuk duhet të humbim ujin duke larë enët. Nuk duhet të humbim ujin duke larë rrobat. Qoftë shembullin e ujit nëse merrni, do të shihni se populli ynë dhe disa popuj të tjerë të përparuar sa shumë e shpërdorin ujin. Kam parë që disa njerëz lëshojnë çezmën dhe qëndrojnë para saj pa u merakosur fare se sa ujë të ngrohtë apo të ftohtë po e derdhin kot, edhe pse atyre u duhej shumë pak. Realisht, uji është një bekim i madh i Zotit të Madhërishëm, të cilin duhet ta vlerësojmë. Pavarësisht nga fakti se çfarë humbjeje ekonomike pësojmë nga keqpërdorimi i ujit ose çfarë humbjeje pëson shteti nga ai, duhet të dimë se nënvlerësimi i një bekimi quhet mosmirënjohje.

Pra, me vetëpërmbytje në asnjë mënyrë nuk do të thotë se t'i edukojmë fëmijët të mos merakosen për humbjet. Të dyja këto duhet të ecin paralelisht. Pasja e vetëpërmbytjes do të thotë nëse dikush rastësisht shkakton ndonjë humbje, duhet ta duroni e t'i thoni – nuk ka problem, ndodhin këto gjëra. Ata që mësohen me kurajë të lartë, kur rriten bëhen të aftë të përballojnë edhe humbje të mëdha. Disa herë katastrofat natyrore bien në atë mënyrë që brenda pak çastesh shkatërrojnë ara të tëra. Ata që nuk mësohen me kurajë në gjëra të vogla, në raste të tilla zënë të flasin keq edhe për Zotin. Mosdurimi ka një lidhje të ngushtë me egoizmin, i cili, çdo gjë i tregon njeriut më



poshtë se vetja e tij. Atij i duket e mbarë për aq kohë sa i sjellë dobi, por sapo t'i vijë dëm, sado i vogël qoftë, ai e humbë kurajën. Njeriu që sillet i padurueshëm me njerëzit e tjerë, pra me robërit e Zotit, përfundimisht i tillë do të tregohet edhe me Zotin. Prandaj *Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s.* na mësoi këtë sekret:

مَنْ لَمْ يَشْكُرِ النَّاسَ لَا يَشْكُرِ اللَّهَ

*“Ai që nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon as Zotin”.*

(Kenzul-Ummal, hadithi nr. 6440)

Pra, ai që nuk mëson të falënderojë robin, si mund ta falënderojë Zotin? Këtë filozofi të thellë e shohim në jetën tonë të përditshme. Pikërisht kjo aplikohet edhe mbi durimin. Kurse në rastin e fëmijëve, kjo nuk është ndonjë gjë e vogël, por do të sjellë rezultate shumë të mëdha kur të rriten.

Durimi për humbjen që njeriu nuk e eviton dot, quhet kurajë. Por prirja për të pritur çdo humbje me qetësi nuk është kurajë, por budallallëk, injorancë dhe në disa raste edhe mosmirënjohje. Prandaj, kur t'u mësoni fëmijëve durimin dhe kurajën, mësojini edhe të vlerësojnë çdo gjë që kanë.

### **Mos prishni bekimet e Zotit!**

Siç ju thashë pak më parë, edhe këtu në Angli, kam parë që njerëzit në përgjithësi nuk e vrasin mendjen për humbjen e ujit dhe të (sistemit të) ngrohjes. Edhe pakistanezët që mërguan dhe tashmë banojnë këtu, ndezin kaloriferët pa arsye. Ndezin zjarr pa arsye. Madje edhe sobën e lënë të ndezur pa marrë parasysh se ka ndonjë tenxhere apo jo mbi të. Ka gra që nuk merakosen. Ujin e derdhin

pandërprerë dhe pa arsye, ndërkohë mund të plotësojnë nevojat duke përdorur një sasi shumë më të vogël sesa ajo që harxhojnë. Njerëzit nëse do t'i kushtojnë vëmendje kësaj pike, padyshim që do t'i bëjnë dobi gjithë popullit, kjo dihet. Por, ajo që është themelore, është se vetia për të konsumuar çdo gjë aq sa duhet, ndihmon çdo njeri për të ndërtuar moralet e tij dhe, përmes saj, çdo njeri do të kontribuojë shumë edhe në edukimin e fëmijëve.

Për rrymën elektrike, për shembull, kam parë që njerëzit i lënë dritat të ndezura kot nëpër dhoma. Ndezin dritat, ndezin radio apo televizor dhe largohen nga dhoma. Të gjitha këto rrinë të ndezura në dhoma boshe. Shumë herë u them edhe fëmijëve të mi:

“Mos kemi xhindë në shtëpi, sepse pashë në dhomë se televizori dhe dritat ishin të ndezura! Paskemi ndonjë krijesë të padukshme në shtëpi që vjen dhe na i ndez këto gjëra! Të paktën njeriut nuk i ka hije që t'i prishë bekimet e Zotit kështu më kot”.

Pra, vazhdimisht duhet t'i edukojmë fëmijët, por me durim e jo me keqsjellje. Të dyja vetitë duhet t'ua mësoni paralelisht: t'ua mësoni edhe durimin, edhe prirjen për t'i shmangur humbjet. Nuk duhet t'i shkaktoni asnjë lloj humbjeje kombit tuaj dhe kjo do t'ju bëjë dobi në radhë të parë vetë juve dhe familjes suaj dhe, fëmijët tuaj kur të rriten, do të shohin rezultate madhore. Tregtarët që nuk vrasin mendjen për humbjet e vogla, nga ana e tyre tregojnë se gjoja nuk u ndodh gjë nëse humbin këtë apo atë gjë dhe kujtojnë se do të fitojnë prapë. Ky është naivitet. Tregtari i mirë është ai që edhe humbjen më të vogël nuk e anashkalon. Pra, të kesh kurajë dhe durim nuk do të thotë t'u bësh sehir humbjeve dhe të mos veprosh për t'i shmangur ato.

#### 4. Dhembshuria ndaj të varfërve dhe shprehia për t'ua larguar dhimbjet

Vetia e katërt është dhembshuria ndaj të varfërve dhe shprehia për t'ua larguar dhimbjet. Edhe këtë duhet t'ua mësoni fëmijëve që në vegjëli. Nënata e dhembshura kur rrisin fëmijët duke i ushqyer me fjalët dhe moralin e dhembshurisë, me bekimin e Zotit të Madhërishëm, përgatitin një popull madhor për të ardhmen, i cili meriton të quhet “populli më i mirë” (*hajru ummet*). Por nënata që janë egoiste dhe fëmijëve të tyre ua kujtojnë dhimbjet e veta, ndërsa dhimbjet e të tjerëve jo, krijojnë një popull egoist, i cili bëhet makth për njerëzit. Prandaj, që të krijoni te fëmijët dhembshurinë ndaj njerëzve, jo vetëm që është jashtëzakonisht e nevojshme, por pa këtë, ju nuk mund të arrini synimin tuaj të lartë, për të cilin jeni krijuar. Kurani Famëlartë thotë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ

“Jeni umeti më i mirë që ka dalë për njerëzimin”.

(Kurani Famëlartë 3:111)

Pra, jeni *umeti* (populli) më i mirë në botë, të cilin Zoti i Madhërishëm e ka krijuar për dobinë e mbarë njerëzimit. Prandaj, nëse nuk do t'ua mësojmë fëmijëve dhembshurinë ndaj njerëzve dhe nëse nuk do t'u kërkojmë vepra praktike në këtë kuadër, ose nëse nuk do t'u mësojmë punët që do t'ua mbushin zemrën me dhembshurinë ndaj të varfërve dhe që mund t'u jepnin shijen e kësaj vetie që në vegjëli, do të humbim synimin kolektiv të jetës sonë. Kur them t'ua jepni shijen e kësaj vetie, e kam fjalën që t'i mësoni fëmijët me punët, me të cilat ata mund t'ua largojnë dhimbjet të tjerëve. Me këtë ata do të ndiejnë kënaqësi. Nëse do t'i edukoni thjesht me fjalë goje, ata nuk

mund të fitojnë ndonjë kënaqësi. Dhe mirësia derisa nuk shijohet, nuk mund të hedhë rrënjë dhe deri atëherë ajo mbetet thjesht një këshillë.

Për këtë arsye, kjo ka dy aspekte. Së pari, tregojuni fëmijëve tuaj përralla të bukura, jepuni këshilla mësimdhënëse, duke treguar ngjarje të ndryshme që i nxisin të krijojnë dhembshuri ndaj të varfërve dhe i motivojnë t'ua heqin brengat të brengosurve. Kur të shohin një hallexhi, pra, një njeri që ndodhet në vështirësi, ndërgjegjësojini fëmijët që ai njeri duhet ta kapërcejë këtë shqetësim dhe ne duhet të përpiqemi për t'ia larguar vështirësinë. Pra, krijoni një ndjenjë te fëmijët që të shërbejnë, por jo vetëm. Duhet të krijoni edhe mundësi për ta shfaqur këtë ndjenjë. Këtu, në jetën e përditshme, nuk gjejmë mundësi të tilla, sepse ky është një shtet ku ka një distancë shumë të madhe midis të pasurve dhe të varfërve, ose midis familjeve mesatare dhe atyre të varfra. Por në vendet tona, pra në vendet e varfra, në vendet e botës së tretë, të pasurit dhe të varfrit jetojnë bashkë. Të pasurit çdo ditë e shohin dhe e ndiejnë varfërinë duke u sflitur nëpër rrugicat dhe pazaret e tyre. Kështu që, nga njëra anë, kjo punë është shumë e lehtë atje, pra, që t'i edukoni fëmijët që në vegjëli t'u largojnë dhimbjet njerëzve, por nga ana tjetër është edhe e vështirë, sepse hallet janë kaq të shumta, saqë duket sikur njeriu e ka të pamundur zgjidhjen e tyre. Mbase, pikërisht për këto vende dhe pikërisht në këtë shoqëri, poeti Ghalib ishte shprehur:

کون ہے جو نہیں ہے حاجت مند  
کس کی حاجت روا کرے کوئی

*Kush nuk është nevojtar?!*  
*Kujt t'ia plotësoj nevojën?!*

(“Divan-e-Ghalib”, f. 330)

Kjo nuk do të thotë se ngaqë janë shtuar shumë nevojtarë dhe ne nuk mund t'ua plotësojmë nevojat të gjithëve, ne të heqim dorë nga plotësimi i nevojave të të tjerëve, por do të thotë se na do zemra që t'ia plotësojmë nevojën gjithsecilit dhe ngaqë nuk mundemi, pyetja është se kujt t'i plotësojmë e kujt jo.

Kështu që, plotësojini nevojat kujtdo, me sa të keni mundësi. Këtë gjë bëjeni edhe vetë, dhe mësoni edhe fëmijët ta bëjnë. Fëmijët që do të mësohen me këtë virtyt që në vegjëli, arrijnë të shijojnë një kënaqësi, e cila do t'i bëjë që këtë të mirë ta kenë përherë. Kur të rriten dhe ata do të jenë anëtarë të organizatës *Khudamul-Ahmedia* apo *Laxhna Imail-lah*, organizatat e tyre përkatëse nuk do të kenë nevojë të punojnë shumë për virtytet e tyre. Ato do të gjejnë anëtarë të përgatitur, të virtytshëm dhe që do të jenë në gjendje për të bërë punë madhore.

## **5. Guximi dhe kuraja e fortë**

Pika e pestë dhe e fundit që kam zgjedhur për fjalimin e sotëm është guximi dhe kuraja e fortë. Vullneti dhe kuraja e fortë mund të bashkëjetojnë me zemërbutësinë. Nëse ato nuk arrijnë të bashkëjetojnë te dikush, ai njeri mund të jetë i dobët, por jo i virtytshëm. Të jeni zemërbutë, asnjëherë nuk do të thotë të trembeni para vështirësive dhe të mos gjeni forcën për t'u bërë ballë atyre.

Në këtë aspekt, *Hazret Ebu Bekri* r.a. që gjendej në gradën e të vërtetit (e *sidikut*), gjithmonë do të mbetet një shembull në histori. Këtë model, padyshim, ai e ka marrë nga *Hazret Profeti Muhammed* s.a.v.s., megjithatë, në jetën e tij, erdhi një moment, kur ky virtyt tek ai shkëlqeu aq fuqishëm, saqë gjithmonë mund ta paraqesim shembullin e tij para botës. Ai ishte një njeri tejet zemërbutë. Por,

kur Islami u përball me një gjëmë që ditën e parë të Kalifatit të tij, madje me një gamë gjëmash, i njëjti që shquhej për zemërbutësinë aq shumë, saqë duke dëgjuar qoftë shqetësime të vogla të të tjerëve i shkonin lotët si rrëke, u vendos fuqishëm përballë tyre, sikur të ishte një mal përpara furtunës. Nuk mund të lindte pyetja që ai të bënte edhe lëkundjen më të vogël. Në këtë mënyrë *Hazret Ebu Bekër Sidiku r.a.*, edhe pse zemërbutë, i tregoi botës sesi mund të shfaqej si një mal madhështor i kurajës.

Pra, të jesh zemërbutë asnjëherë nuk do të thotë që të tregohesh i dobët përballë vështirësive. Këtë virtyt duhet ta sjellim tek fëmijët që, “ne nuk e pranojmë dështimin”. Në lidhje me *Hazret Mesihun e Premtuar a.s.* kemi një thënie, një thënie madhështore, e cila rrezaton fuqishëm virtytin e tij në fjalë:

میری سرشت میں ناکامی کا خمیر نہیں۔

**“Nuk ka brumë humbjeje në natyrën time”.**

(“Ruhani Khezain”, vëll. 9, UK, 2009, “Envarul-Islam”, f. 23)

Kjo është një thënie shumë e bukur dhe shumë e fortë e Mesihut të Premtuar a.s..

Kështu që, edhe ata që janë të lidhur me *Hazret Mesihun e Premtuar a.s.*, kurrsesi nuk duhet të kenë brumin e humbjes në natyrën e tyre. Ky guxim dhe kjo kurajë duhen brumosur tek fëmijët që në vegjëli, vetëm atëherë ajo mund të rrënjoset te ta. Ka njerëz që dëshpërohen qoftë edhe për gjëra të vogla. Dikush ngel në provim, zhgënjehet nga jeta. Dikujt nuk i përmbushet një dëshirë e jetës, i bie një tërmet në jetën e tij. Njerëzve të tillë u thotë mendja – nuk e di a ekziston Zoti apo jo?! Gjithësia e tyre e vogël, e ndërtuar prej fijesh kashte, me një lëkundje të lehtë shembet.

Për këtë arsye, popujt që synojnë të bëjnë vepra madhështore në botë, që kanë qëllime madhore, që kanë përgjegjësi të mëdha, periudha e vështirësive të të cilëve nuk shtrihet në pak vite, por përgjatë shekujve, të cilëve do t'u duhet t'i bëjnë ballë me burrëri çdollos vështirësi, që do të ndeshen me çdo armik të fortë dhe që do të arrijnë edhe ta mundin atë, nëse fëmijëve të tyre nuk u jepet mësimi i kurajës së gjerë që në vegjëli, ata dhe brezat e tyre të ardhshëm nuk mund t'i realizojnë dot këto detyra.

Andaj, është shumë e nevojshme që, nga njëra anë, të kemi fëmijë gjuhëmbël, zemërbutë, që shqetësohen duke parë qoftë shqetësimet e vogla të të tjerëve, të cilëve u loton zemra duke parë brengat e të tjerëve, por nga ana tjetër, të jenë edhe mal kuraje, të jenë model dhe mësim për të tjerët për kurajë të gjerë.

Këto janë pesë virtyte themelore, të cilat, mendoj që organizatat tona ndihmëse t'i kenë parasysh në mënyrë të veçantë në programet e tyre të edukimit. Nëse ato do të përqendrojnë vëmendjen kryesore te to në të gjitha planet e tyre, besoj se do t'i sjellin dobi njerëzimit jo vetëm në shekullin e ardhshëm, por për shumë shekuj në vijim. Nëse sot Xhemati Ahmedia do të vendoset fuqimisht në këto pesë virtyte dhe të kemi besim që edhe pasardhësit tanë do t'u përmbahen fort këtyre virtyteve dhe do t'i përhapin ato, atëherë besoj se mund të japim shpirt me qetësi para Zotit tonë të Dashur dhe mund të jemi të bindur që përgjegjësinë e madhe me të cilën jemi të ngarkuar, e kemi përmbushur sipas mundësive tona.

### **Namazi është pjesa më e rëndësishme në adhurim**

Një tjetër pikë që dëshiroj të cek shkurtimisht është adhurimi. Shumë herë i kam tërhequr vëmendjen xhematit tonë që duhet t'u japim rëndësi të madhe çështjeve themelore dhe më e rëndësishmja

dhe më themelorja prej tyre është namazi. Ende ka shumë lloj boshllëqesh në namazet tona, që duhet t'i mbushim. Sigurisht, ato kanë lidhje me namazet e niveleve të larta dhe për këtë kam folur gjerësisht më përpara. Por, sot dua t'ju tërheq vëmendjen te një dobësi bazë, që ekziston te shumë të rinj tanë, pra te brezi i sotëm. Ka shumë fëmijë që nuk janë mësuar me faljet e pesë vakteve. Ka shumë të rinj që nuk i kanë shprehur namazet e pesë vakteve. Ka shumë pleq që nuk e kanë bërë zakon faljen e pesë vakteve. Nëse e shohim këtë si diçka të përditshme, duhet të shqetësohemi. Përse organizatat ndihmëse nuk shqetësohen sa duhet nga kjo? Përse ato nuk e shohin këtë dobësi dhe përse nuk angazhohen siç duhet për ta larguar atë?

Nuk mjafton vetëm të falni namazin, por është shumë e nevojshme që t'ia dini edhe përkthimin. Përkthimin e namazit duhet ta dijë çdo ahmedian, qoftë fëmijë, qoftë i rritur, qoftë burrë, qoftë grua. Për çdo njeri është e rëndësishme që të mësojë namazin me gjithë përkthimin. Përkthimin e namazit duhet ta dijë deri në nivelin saqë të kuptojë fjalët e namazit gjatë faljes.

Ka shumë tema të thella në kuadër të adhurimit, të cilat thellohen në shumë aspekte të tjera të mëtejshme. Por, më bazikja prej tyre është që i gjithë xhemati ynë të vendoset mbi namazin. Kurani Famëllartë nuk ka porositur kaq shumë për ndonjë mirësi tjetër, siç ka porositur për adhurimin dhe namazin. Gjithashtu, bashkë me porosinë për namazin, Zoti i Madhërisëm ka dhënë edhe porosinë për të pasur dhembshuri ndaj njerëzve.

Shkurt, shpirti i mësimeve të Kuranit është që ne ta gjallërojmë adhurimin dhe kaq fort ta vendosim atë, saqë asnjë sprovë, asnjë tërmet dhe asnjë vështirësi të mos na i lëkundë namazet tona. Hapi i parë që duhet hedhur në këtë drejtim është që çdokush nga ne të dijë namazin me përkthim dhe të bëjë shprehur faljen e namazeve të pesë vakteve.



Një gjë tjetër që duhet të shoqërohet bashkë me këtë është recitimi i Kuranit çdo mëngjes. Çdokush që fal namazin e sabahut, le ta bëjë shprehi edhe recitimin e Kuranit pas sabahut, sado pak qoftë.

Nëse arrijmë t'i vendosim këto baza, mund të ndërtojmë ndërtesa të mëdha të adhurimit sipër tyre. Pra, mund të arrijmë në lartësitë e mëtejshme të adhurimit. Por, po nuk i patëm këto baza, nuk do të kemi as ndërtesat që vijnë sipër.

### **Udhëzime për organizatat ndihmëse**

Për këtë arsye, organizatat *Khudamul-Ahmedia*, *Ensarullah* dhe *Laxhna imail-lah*, në programet e tyre të ardhshme, le të fokusohen që të mos ketë asnjë njeri në mesin e tyre, që nuk di namazin me përkthim dhe që nuk i fal pesë vaktet. Gjërat e tjera inshaAllah do të mësoni gradualisht. Programi im është që në këtë aspekt t'i vëzhgoj të gjitha organizatat ndihmëse, t'i shkurtoj raportet e tyre përkohësisht, të pres nga ato që të mos më dërgojnë raporte të shtjelluara, të cilat as vet nuk do të mund t'i shoh, por, ta përmbledhin raportin e tyre që dëshirojnë të ma dërgojnë.

Pra, mos më tregoni se sa pemë keni mbjellë, si i keni vaditur, por më tregoni se sa fruta janë pjekur. Më jepni raport se tek sa ahmedianë i keni gdhendur këto pesë virtyte; sa fëmijë, sa të rritur, sa burra e sa gra kanë premtuar se nuk do të gënjejnë në të ardhmen dhe ju, si organizata ndihmëse, çfarë pune keni bërë në këtë drejtim. Pra, tani për tani më jepni raport vetëm për këto pika. Çfarë pune keni bërë për të bërë këtë analizë? Çfarë masash keni marrë që këto virtyte të gdhenden më shumë se përpara tek anëtarët e xhematit? Përveç sasisë së frutave, mund të më tregoni edhe për masat mbrojtëse që keni marrë për to. Pra, përpiquni të keni fryt në këtë drejtim dhe

pastaj përpikuni edhe për ta mbrojtur atë. Këtë pjesën e dytë mund ta përmendni vetëm shkurtimisht në raportet tuaja.

Së dyti, dua të di nga raportet tuaja se sa ahmedianë, fëmijë e të rritur që nuk i falnin namazet e pesë vakteve, kanë filluar t'i falin, ose sa janë nga ata që nuk falnin asnjë namaz dhe tani kanë filluar të falin një a dy namaze. Mua më mjafton vetëm numri i tyre. Në raportin vijues të mos i përfshini ata që i keni numëruar, por të tregoni për prurje të reja. Gjithashtu, të më tregoni se sa ahmedianë nuk dinin namazin me përkthim dhe sa ahmedianëve ua keni mësuar dhe deri në çfarë mase. Edhe kjo do të ketë shkallë të ndryshme. Dikush tani mund të ketë filluar ta mësojë përkthimin e namazit e dikush tjetër mund ta ketë mësuar tërësisht. Pra, këtë gjë mund të ma tregoni në dy pjesë: kaq veta po e mësojnë përkthimin e namazit dhe kaq fatlumë janë ata që e kanë mësuar tashmë përkthimin.

Këto pra janë detyra të vogla për ju. Të gjitha organizatat ndihmëse le të përkushtojnë gjithë vëmendjen e tyre te to. Detyra të tjera gjithashtu do të vijojnë, por përkohësisht, ato do të kenë rëndësi dytësore. Nga kjo unë shpresoj se *inshaAllah te'ala*, do të hidhen themelet e fuqishme të xhematit në atë mënyrë, saqë me bekimin e Zotit të Madhërishtëm, ne do të mund të bëjmë vepra madhështore për vendosjen dhe ngritjen e ngrehinës së Islamit në të gjithë botën. Allahu na e mundësoftë këtë! Amin!

*(Marrë nga "Khutbaat-e-Tahir", vëll. 8,  
hutbeja e dt. 24 nëntor 1989, f. 755-770)*

.....

## Shpjegimi i termave

- Atfalul-Ahmedia* Kuptimi leksikor: fëmijët e Ahmediatit. Si term i referohet organizatës ndihmëse brenda Xhematit Musliman Ahmedia, në të cilën bëjnë pjesë meshkujt muslimanë ahmedianë të moshës 7-15 vjeçare. Kjo organizatë u themelua nga *Hazret Kalifi i Dytë* i Xhematit Musliman Ahmedia në vitin 1938 dhe vepron nën organizatën *Khudamul-Ahmedia*.
- Ensarullah* Kuptimi leksikor: ndihmësit e Allahut. Si term i referohet organizatës ndihmëse brenda Xhematit Musliman Ahmedia, në të cilën bëjnë pjesë meshkujt ahmedianë të moshës mbi 40 vjeçare. Kjo organizatë u themelua nga *Hazret Kalifi i Dytë* i Xhematit Musliman Ahmedia më 26 korrik 1940.
- InshaAllah te'ala*  
*Khudamul-Ahmedia* Në dashtë Allahu i Lartësuar. Kuptimi leksikor: shërbëtorët e Ahmediatit. Si term i referohet organizatës ndihmëse brenda Xhematit Musliman Ahmedia, në të cilën bëjnë pjesë meshkujt muslimanë ahmedianë të moshës 15-40 vjeçare. Kjo organizatë u themelua nga *Hazret Kalifi i Dytë* i Xhematit Musliman Ahmedia në vitin 1938.
- Laxhna Imail-lah* Kuptimi leksikor: Grupi i robërshave të Allahut. Si term i referohet organizatës ndihmëse brenda Xhematit Musliman Ahmedia, në të cilën bëjnë pjesë femrat muslimane ahmediane të moshës mbi 15 vjeçare. Kjo organizatë u themelua nga *Hazret Kalifi i Dytë* i Xhematit Musliman Ahmedia në vitin 1922.
- Nasiratul-Ahmedia* Kuptimi leksikor: ndihmëtares e Ahmediatit. Si term i referohet organizatës ndihmëse brenda Xhematit Musliman Ahmedia, në të cilën bëjnë pjesë femrat muslimane ahmediane të moshës 7-15 vjeçare. Kjo organizatë u themelua nga *Hazret Kalifi i Dytë* i Xhematit Musliman Ahmedia në vitin 1945 dhe vepron nën organizatën *Laxhna Imail-lah*.
- Takva* Takva, në arabisht, do të thotë “drojë prej Zotit”. Ajo gjithashtu nënkupton se një besimtar i vërtetë, duke qenë i devotshëm, gjithmonë i shmanget mospëlqimit të Zotit dhe mundohet ta kënaqë Atë.

## **Shkurtesat**

- s.a.v.s. *Selallahu alejhiveselam* (Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i *Hazret* Profetit Muhammed <sup>s.a.v.s.</sup>.
- a.s. *Alejhiselam* (Paqja qoftë mbi të!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë profeti të Allahut.
- r.a. *RadijAllahu anhu/anha/anhum* (Allahu qoftë i kënaqur me të/ta!), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë sahabi a sahabeje të ndonjë profeti.

## **Rreth autorit**

*Hazret Mirza Tahir Ahmed* (1928-2003), Allahu e mëshiroftë pafundësisht, një njeri i Zotit, zë i kohës, orator i madh, dijetar i thelluar me inteligjencë fenomenale, shkrimtar i gjithanshëm, studiues i mprehtë i shkencës krahasuese të feve, ishte prijës, Imam, udhëheqës shpirtëror i më shumë se 10 milionë ndjekësve të tij të devotshëm muslimanë ahmedianë anembanë botës dhe ishte Kalifi i Katërt i *Hazret Mirza Ghulam Ahmedit* (Mesihut të Premtuar a.s.) një detyrë në të cilën ai u zgjodh në vitin 1982.

Pas shpalljes së ligjit anti-Ahmedian, të datës 26 prill 1984, nga ana e diktatorit pakistanez gjeneral Zia-ul-Hak, *Hazret Mirza Tahir Ahmedit* iu desh të largohej nga Pakistani, vendi i tij i dashur, për të mërguar në Angli, nga ku do të lançonte kanalën MTA (Televizioni ndërkombëtar i Xhematit Musliman Ahmedia), i cili do të transmetonte (dhe vijon të transmetojë) emisionet e tij 24 orë në të katër anët e botës.

*Hazret Mirza Tahir Ahmed* ishte jo vetëm një lider fetar, por edhe një mjek i homeopatisë me famë botërore, një poet me dhunti të rrallë dhe një sportist.

Shkollën e mesme ai e nisi në Kadian, për ta vazhduar më pas në Kolegjin Shtetëror të Lahorit të Pakistanit. Pas përfundimit të shkollës së lartë me nota të shkëlqyeshme në Universitetin “Xhamia Ahmedia Rabvah” të Pakistanit, ai u diplomua për gjuhën arabe nga Universiteti Panxhab i Lahorit. Nga 1955 deri në 1957, ai vijoi

Shkollën e Studimeve Orientale dhe Afrikane në Universitetin e Londrës.

I inspiruar prej Zotit të Madhërishëm, ai shfaqti dituri të thella mbi Kuranin e Shenjtë, të cilin edhe e përktheu në gjuhën urdu, ashtu siç redaktoi pjesërisht përkthimin e tij në anglisht, të bërë nga *Hazret Maulvi Sher Ali r.a.*, duke i shtuar, gjithashtu edhe shënime shpjeguese. Vepra “Revelation, Rationality, Knowledge and Truth” është magnum opusi i tij.

Pavarësisht se ai nuk iu nënshtrua ndonjë arsimimi formal për filozofinë, kishte një prirje tejet të mprehtë në filozofi dhe për këtë arsye, diti të trajtonte edhe pyetjet më të vështira teologjiko-filozofike. Qasja e tij intelektuale gjithmonë ka qenë racionale dhe shkencore. Laikët befasoheshin nga dijet e thella shkencore që ai kishte, sidomos në shkencat e jetës, që e tërhoqën shumë. Me njohuritë e gjera mbi psikologjinë humane, me mendjen analitike të inteligjencës së lartë dhe me analizat brilante që bënte, ai magjepste dëgjuesit dhe lexuesit e tij.

## **Adresat**

### **Shqipëri**

Rr. "Pavarësia"  
Mëzez, Tiranë  
Kutia postare 8176  
darulfalah@gmail.com

+355 672168054  
+355 662974992  
+355 695876901

### **Kosovë**

Rr. "Holger Pedersen"  
Lagjja e Spitalit,  
Prishtinë  
amj.kosovo@gmail.com

+377 44817813  
+381 38558436  
Fax: +381 38512408

**[www.alislam.al](http://www.alislam.al)**

(1) Vërtetësia, (2) butësia në fjalë, (3) vetëpërmbajtja, (4) dhembshuria dhe (5) guximi.

“Popujt fetarë nuk mund të ngrihen, pa ngritjen e virtyteve të tyre. Është krejtësisht i pavërtetë mendimi që njeriu të jetë edhe i keq në sjellje, edhe të jetë njohës i Zotit. Prandaj, në ngritjen e popujve fetarë, gjëja më e rëndësishme është ngritja e virtyteve të tyre. Një popull sa më shpejt ta fillojë këtë ngritje, aq më mirë do të jetë për të dhe aq më e lehtë do të jetë rrugëtimi i tij ... Popujt që synojnë të bëjnë vepra madhështore në botë, që kanë qëllime madhore, që kanë përgjegjësi të mëdha, periudha e vështirësive të të cilëve nuk shtrihet në pak vite, por përgjatë shekujve, të cilëve do t’u duhet t’i bëjnë ballë çdolloj vështirësie, që do të ndeshen me çdo armik të fortë dhe që do të arrijnë edhe ta mundin atë”, duhet t’i kenë këto virtyte. Por, si mund të arrihen ato? Përgjigjen e gjeni brenda këtij libërthi.

---

*This is the Albanian translation of a Friday sermon entitled “Five Basic Morals”, delivered by Hazrat Mirza Tahir Ahmad r.a., Khalifatul Masih IV.*

www.alislam.al



ISBN 1-84880-259-5



9 781848 180259